# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-446732**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "Se çfarë do flasim e dimë ne"! Kryetar i Unionit të Gjyqtarëve përplaset me Ulsi Manjën, deputeti i fik mi krofonin |
| ADRESA | `https://versus.al/politike/se-cfare-do-flasim-e-dime-ne-kryetar-i-unionit-te-gjyqtareve-perplaset--i46604` |
| BURIMI | versus.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 16:34:28 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 16:10:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `cc0d5bfb3a615b8fbceed766bbcb9c3df39c2d9ec4d4a4a41197af7ddf0833f3` |
| TEKSTI | `09fc69fa81b77fad28a685c715d25dceed457ee3743986a366c9fc5f8f166988` |
| PAMJA | `4e18f233092d8b4919ccb3e26d2c660002f5a66c86e0ec2c914d646065e00406` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1a261464536bd26571527395d8cdb9e03c21c3a44d9dba999baf48404a2e784a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `4768c0741a99d31c0c1ea2cb7e5bcdc39124f7af2f5dea963bef58ba2da55aae` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1a261464536bd26571527395d8cdb9e03c21c3a44d9dba999baf48404a2e784a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




AKTUALITET

[Kokaina e fshehur tek pulat e AMG Food, e grupit të Gert "gjeneralit"? Belgët zbardhin enigmën e 37 pakove të kapura në Portin e Durrësit](#)

15 Shtator 2026, 16:35

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në



Created and monetized by

POLITIKË / 15 Shtator 2026, 18:10

# "Se çfarë do flasim e dimë ne"! Kryetar i Unionit të Gjyqtarëve përplaset me Ulsi Manjën, deputeti i fik mikrofonin

Hoxha këmbënguli se duhej t'i jepej mundësia të shprehte qëndrimin e Unionit pa u orientuar se çfarë duhej të diskutonte.

Shkruar nga Versus

Shkruar nga Versus



Gjatë diskutimit në Komisionin kuvendor të Ligjeve, për pr/ligjin e pagave të gjyqtarëve, pati dhe momente tensioni mes kryetarit të komisionit deputetit socialist Ulsi Manja dhe kryetarit të Unionit të Gjyqtarëve, Gerd Hoxha.

Hoxha kërkoi që Unioni të shprehej edhe për vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ndërsa Manja theksoi se e nevojshme do të ishte të diskutohej për projektligjin që po shqyrtohej nga komisioni.

Hoxha këmbënguli se duhej t'i jepej mundësia të shprehte qëndrimin e Unionit pa u orientuar se çfarë duhej të diskutonte.

Në një moment, pas replikave mes tyre, Manja urdhëroi fikjen e mikrofonit të Hoxhës.

Kryetari i Gjykatës së Tiranës deklaroi se gjyqtarët janë të gatshëm të negociojnë mënyrën e pagesës së detyrimeve të prapambetura, edhe pse, sipas tij, ato u takojnë menjëherë në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

"Neve na dhimbset buxheti i shtetit. Jemi gati të negociojmë pagesën e prapambetur. Të mos e marrim menjëherë, edhe pse na takon menjëherë sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, por ta zgjasim edhe në 2 apo 3 vite pagesën", deklaroi ai.

Hoxha tha gjithashtu se mund të negociohet edhe për paditë individuale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilat, sipas tij, krijojnë një kosto të konsiderueshme për buxhetin e shtetit.

Sipas tij, një pjesë e konsiderueshme e kostos së pagave të prapambetura lidhet me institucione të tjera që kanë paga të indeksuara me atë të gjyqtarëve.

"Ne jemi gati në negociojmë dhe paditë individuale të gjyqtarëve dhe prokurorëve nëpër gjykata, që dhe ato kanë një kosto gati që e rëndojnë 17% buxhetin e shtetit. Kosto e pagave të prapambetura nuk është kostoja jonë të nderuar. Ne kemi 50% të kësaj shume, janë kostot e institucioneve të tjera që referohen te paga e gjyqtarit. Këto e kanë ngritur 50%",- tha Hoxha.

Poll




POLITIKË

## [SHBA luftë karteleve të drogës, zv/Sekretari i Shtetit, Daniel Lawton: Po bashkëpunojmë me NATO-n për të goditur në Shqipëri organizatat kriminale transnacionale]

15 Shtator 2026, 18:04

^ekstrakti^






POLITIKË

["Ligjet" miratojnë pr/ligjin e PS për pagat e magjistratëve, gjykatësit e prokurorët paralajmërojnë dërgimin në Kushtetuese]

15 Shtator 2026, 17:50

^ekstrakti^



POLITIKË

[Protestat në Shqipëri, ambasadori kroat: Shenjë e një demokracie të shëndetshme, pakënaqësitë e qytetarëve të dëgjohen!]

15 Shtator 2026, 16:02

^ekstrakti^



POLITIKË

[“Përsëri Tirana pa kokë”, Rama reagon pas vendimit për Erion Veliajn: Kalvari i kryebashkiakut është unikal në historinë e Europës]

15 Shtator 2026, 15:23

^ekstrakti^



POLITIKË

["Mos e bëni kaq të madhe", deputetja e PS ngatërron 'magjistarin' me 'magjistratët': Ishte lapsus]

15 Shtator 2026, 13:25

^ekstrakti^



POLITIKË

[**Qindra aplikime për rrjetin MIA, Rama: Si ka mundësi kjo dëshirë për të punuar me propagandën e ‘regjimit’?**]

15 Shtator 2026, 09:48

^ekstrakti^



POLITIKË

[**Hapet Konsullata e Nderit në Napoli, Rama merr pjesë në ceremoninë e inaugurimit**]

14 Shtator 2026, 20:47

^ekstrakti^



POLITIKË

[**Bregdeti i Semanit do të mbushet me parqe foto voltaike? Bashkia Fier hap 5 tendera për dhënie me qira të 391 mijë m2 tokë**]

14 Shtator 2026, 20:03

^ekstrakti^

[**Të fundit**]



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.